


# Memento

Për prindërit dhe fëmijët  
e tyre

...EDHE  
PRINDËRIT  
KANË  
DETYRA !...

...LEXOJENI  
KËTË  
MEMENTO...



MIX & REMIX



REPUBLIQUE  
ET CANTON  
DE GENEVE

POST TENEBRAS LUX

## Disa adresa të dobishme

Departamenti i  
arsimit publik,  
kulturës dhe sportit  
[www.ge.ch/dip/](http://www.ge.ch/dip/)

Centrali i policisë  
[www.ge.ch/police](http://www.ge.ch/police)  
tél. 022 427 81 11

Policia Urgjenca  
tél. 117

Shoqatat e  
prindërve  
**fillorja:** [www.gapp.ch](http://www.gapp.ch)  
**cikli i orientimit:**  
[www.fapeco.ch](http://www.fapeco.ch)  
**pas arsimit të  
detyrueshëm:**  
[www.fappo.ch](http://www.fappo.ch)

Pro Juventute  
[www.147.ch](http://www.147.ch)  
tél. 147  
Linjë ndihme

Mbështetje psikologjike  
për të rinjtë dhe  
prindërit  
[www.telme.ch](http://www.telme.ch)

Aksioni Pafajësia  
[www.actioninnocence.ch](http://www.actioninnocence.ch)  
tél. 022 734 50 02  
për çështje që lidhen me  
Internetin dhe rrjetet  
shoqërore.

CIAO  
[www.ciao.ch](http://www.ciao.ch)  
u përgjigjet pyetjeve të  
shumta të bëra prej  
adoleshentëve.

SOS-fëmijët  
[www.sos-enfants.ch](http://www.sos-enfants.ch)  
tél. 022 312 11 12  
linjë e ndihmës për fëmijët  
dhe të rinjtë.

Udhëkryqi adiksionet  
[www.carrefouraddictions.ch](http://www.carrefouraddictions.ch)  
tél. 022 329 11 69

Pika e të Rinjve  
[www.pointjeunes.ch](http://www.pointjeunes.ch)  
tél. 022 420 55 55  
Shërbim informimi,  
parandalimi dhe ndihme  
shoqërore për të rinj e të  
rritur (18-25 vjeç).

Shkolla e prindërve e  
Gjenevës  
[www.ecoledesparents.ch](http://www.ecoledesparents.ch)  
tél. 022 733 12 00

Mosha legale dhe  
mosha e këshilluar për  
të parë filmat që  
shfaqen në salla  
kinemaje  
[www.geneve.ch/filmages](http://www.geneve.ch/filmages)

Kjo fletëpalosje është ribotim dhe frymëzohet nga versionet e Lozanës dhe Prilisë, si dhe ato të kantoneve të Zhyrasë dhe Friburgut

## Hyrje

Për t'u lejuar qytetarëve/eve të jetojnë në harmoni të plotë dhe t'i ruajnë të rinjtë nga sjelljet me risk, por edhe për të mbështetur prindërit në misionin e tyre edukues, autoritetet kanë miratuar ligje.

Ato përbëjnë një kuadër të domosdoshëm për të rinjtë, që kanë nevojë për dhembshuri për t'u rritur por edhe për kufij.

Ligji gjenevez për arsimin publik parashikon posaçërisht se është shkolla ajo që siguron formimin e të rinjve, ai i inkurajon prindërit që ta ndajnë këtë përgjegjësi dhe i mbështet ata në detyrën e tyre edukuese.

Ky memento është konceptuar si një vijë lidhëse midis shkollës, të rinjve dhe prindërve. Duke rikujtuar përmbajtjen e disa ligjeve dhe rregulloreve thelbësore, ai ndihmon në caktimin e pikave orientuese dhe nxitjen e dialogut të domosdoshëm për vendosjen e rregullave edukuese, të cilat marrin parasysh detyrat dhe të drejtat e fëmijëve dhe adoleshentëve/eve.

Të rriturit duhet t'u kujtojnë atyre rregullisht ekzistencën e kuadrit ligjor brenda të cilit prindërit janë të ngarkuar të venë kufijt e tyre. Në këtë drejtim, ne dëshirojmë t'i shtojmë përpjekjet tona.



**Kushtetuta federale ganaton për secilin të drejtën për një arsim bazë të mjaftueshëm dhe falas në shkollat publike.**

**Arsimi i detyrueshëm fillon në moshën 4 vjeçare dhe si rregull i përgjithshëm zgjat 11 vjet.\***

Të rinjtë e regjistruar në shkollë janë të detyruar ta frekuentojnë rregullisht atë dhe prindërit janë të detyruar t'i dërgojnë atje fëmijët e tyre; ata mund të dënohen me gjobë nëse nuk e respektojnë këtë detyrim. Ata duhet gjithashtu të sigurohen se fëmijët e tyre u përmbahen rregulloreve shkollore dhe pikërisht se shkojnë në shkollë me veshje që përshtaten me gjendjen dhe vendin.




\* Në Gjenevë, kushtetuta parashikon se formimi është i detyrueshëm deri në moshën e madhorisë.

## 2 | Ambienti publik dhe transportet publike

**Sjellja e të rinjve, ashtu si edhe ajo e të rriturve, duhet të jetë respektuese ndaj njerëzve dhe mjedisit.**

Pikërisht, ndalohet pështyrja, të urinimi, bërja e lojrave të rrezikshme, hedhja e letrave apo mbetjeve të tjera në ambientet publike, ndotja, njollosja e mureve të ndërtesave publike apo private.

Në rast dëmtimi të mjeteve të transporteve publike apo të përdorimit të tyre pa biletë të vlefshme, ndaj autorit/es mund të merren masa penale dhe administrative.



**Ligji zbatohet për Internetin ashtu si për cilëndo hapësirë publike. Ndalohet përhapja dhe stokimi i dokumenteve që çënojnë personalitetin (fyerjet, shpifja), zakonet e mira (për shembull imazhet pornografike), të drejtën e autorit apo që nxisin dhunën, racizmin apo sjellje të tjera të dënueshme.**

Po ashtu, marrja dhe përdorimi i fotografive dhe videove – posaçërisht ato të bëra me telefon dore –apo regjistrimi i zërave pa lejen e personave të interesuar janë të ndaluara. Piratimi i programeve dhe tregtimi i muzikës të regjistruara në rrjet dënohen me ligj. Përdorimi i « tchat »-it (diskutimit), i rrejteve shoqërore (Facebook, Twitter, etj.) dhe blogjeve të tjera kërkon marrjen e disa masave, pikërisht:

Në «tchat»

- Mos të jepet kurrë identiteti, as fotografia, as adresa (të përdoret një pseudonim apo « psuedo »);
- Të mos merret takim me një korrespondent të panjohur;
- Të mos pranohen propozime me karakter financiar, seksual apo që nxisin dhunën;

Në rrjete shoqërore

- Llogaria të parametrohet në mënyrë të tillë që vetëm kontaktet e njohura të kenë qasje në publikime;
- Të mos pranohen kurrë kontaktet me të panjohur;
- Të respektohet e drejta e imazhit dhe jetës private;
- Të mos bëhet regjistrim në Facebook, Twitter, etj. para moshës 13 vjeç.



## 4 | Kinemaja, televizioni dhe lojrat video

**Mosha legale e pranimit në sallat e kinemasë duhet të respektohet. Në rast shkeljeje, të miturit dhe të rriturit që i shoqërojnë mund të dënohen.**

Kanalet e televizionit dhe shpërndarësit e DVD-ve apo lojërave video e tregojnë gjithnjë e më shpesh moshën nën të cilën përdorimi i një produkti nuk këshillohet. Ligji u lejon prindërve të një fëmije të mitur të kthejnë çdo send të blerë prej këtij të fundit pa pranimin e tyre dhe të rimbursohen.



## 5 | Daljet natën dhe lokalet publike

**Të rinjtë nën 16 vjeç, të pashoqëruar nga një person madhor që ka autoritet mbi ta, nuk mund të rrinë jashtë apo në një lokal publik pas mesnatës.**

Këshillohet të qenit gjithnjë i pajisur me kartën e identitetit.

## 6 | Alkooli dhe duhani

**Ndalohet shitja apo dhënia e alkoolit të rinjve nën moshën 16 vjeç.**

**Ndalohet pirja e duhanit prej të rinjve nën 16 vjeç.**


**Birra dhe vera :** lejohet shitja dhe dhënia e tyre personave mbi 16 vjeç. **Alkopopet, premiksi, koktejet, aperitivat dhe pijet e distiluara :** lejohet shitja dhe dhënia e tyre personave mbi 18 vjeç.



## 7 | Drogat e tjera dhe stupefiantët

**Prodhimi, mbajtja, dhënia, shitja, blerja dhe konsumimi i të gjitha drogave, edhe në sasi të vogël, janë të ndaluara.**

**Kjo ka të bëjë me drogat e quajtura « të buta » (kanabi, kërpi, marijuana, etj.) sitetike (akstazia, etj.) apo « të forta » (kokaina, heroina, etj.).**





**Armët e zjarrit, thikat automatike ose « flutur », sprej dhe piperi dhe sendet e tjera të konceptuara për të lënduar (grusht amerikan, shkop gome, nunshaku, etj.) nuk lejohen.**

Mbajtja e sendeve të zakonshëm përdorimi i të cialve mund të shkaktonte lëndime duhet të bëhet objekt i masave të veçanta dhe mund, nëse ndodh, të ndalohej në territorin e shkollës.



**Përtej dhunës të dukshme (grindjet, vandalizmi, etj.), askush nuk ka të drejtë të ushtrojë trysni psikologjike mbi një njeri tjetër, as të kërcënojë tërësinë fizike të dikujt për të marrë diçka prej tij apo për t'i imponuar qëndrime, gjeste dhe kontakte trupore jo të dëshiruara.**

Ndaj të rinjve apo të rriturve mund të merren masa ndëshkuese prej drejtësisë nëse, si autorë apo bashkëfajtorë, kryejnë shkeljet e mëposhtme, pikërisht:

- Sulm seksual ;
- Goditje me dashje, lëndime nga neglizhenca ;
- Përleshje, pjesëmarrje në kacafytje ;
- Kërcënime, ofendime ;
- Dëmtime të pronës : vandalizëm, tag, etj ;
- Vjedhje, mbajtje të sendeve të vjedhura, vjedhje në grup, vjedhje me dhunë, raketim ;
- Ngacmim, ngacmim kibernetik.

Është e rëndësishme që çdo viktimë e një sulmi të flasë me prindërit apo me një të rritur të besuar dhe të merret seriozisht prej tyre. Gjithashtu është e domosdoshme që çdo rast raketimi, dhune kibernetike apo sulmi seksual t'i sinjalizohet policisë me qëllim që këto shkelje të mos mbeten pa u ndëshkuar.



Informacione komunale

Shënime vetjake

**Shtypja: SRO Kundig**  
**Ilustrimet: Mix & Remix**  
**Grafizmi: Largenetwork**  
**Gjenevë, dhjetor 2013**

# Të qenit prind : një rol thelbësor

«Prindërit dhe fëmija, në mënyrë të ndërsjellë, duhet të ndihmojnë njeri tjetrin, të tregojnë ndaj njeri tjetrit kujdesin dhe respektin që kërkon interesi i familjes »

## Kodi civil zviceran

Të jesh prind, nuk është gjithmonë e lehtë dhe leximi i kësaj fletëpalosjeje mund të ngrejë mjaft pyetje. Për të folur për këtë, është gjithmonë e mundur t'i drejtoheni të rriturve të pranishëm në shkollë (arsimtarëve/eve, edukatorëve/eve ; infermierëve/eve shkollore ; asistentëve/eve socialë/e, këshilltarëve/eve socialë/e, psikologëve/eve, autoriteteve shkollore, etj.), policisë dhe shoqatave apo institucioneve të ndryshme.

